



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A  
Kosova Landfill Management Company J.S.C  
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552  
www.kmdk-ks.org

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	01/3
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	2
Nr. Prof. Br. Prof. Prof.No:	3182
Datum: Date:	04.10.23
PRISHTINE/A	
NO.1	

<b>KMDK. SH.A</b>	
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD	
Nr.	01-6412
Dt.	02/10/2023
Shtojcë	1
Prishtinë	

## KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 7 të Statutit të KMDK SH.A, në bazë të Ligjit 03/L-212 të Punës në Kosovë, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave për Ndërmarrje Publike, Bordi i Drejtorëve të Përkohshëm në KMDK SH.A, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.09.2023 miraton:

### RREGULLORE NR.28/2023, PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 02/2017 PËR PAGAT DHE KOMPENSIMET TJERA NË KMDK SH.A

#### Neni 1

1. Neni 9 Paragrafi 3 ndryshohet si në vijim:

1.1 3. Përfshijtur nga paragrafi 2 i këtij neni në rastet e jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë më gjatë se orari i punës (puna jashtë orarit), më së shumti deri në tetë (8) orë në javë.

2. Neni 10 Paragrafi 8 fshihet në tërësi.

#### Neni 2

1. Neni 25 Shpenzimet e telefonisë mobile për Bordin e Drejtorëve dhe punonjësve të KMDK SH.A, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

- 1.1 Të gjithë të punësuarit e KMDK SH.A kanë të drejtën e kompensimit të mbushjeve elektronike mujore për telefoninë mobile të përcaktuar me vendim të Bordit të Drejtorëve.
- 1.2 Lista e kompensimeve të mbushjeve elektronike plotësohet dhe ndryshohet me vendim të Bordit të Drejtorëve sipas propozimit të menaxhmentit të KMDK SH.A.
- 1.3 Lista e kompensimeve të mbushjeve elektronike duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin, pozitën e të punësuarit si dhe shumën e mbushjes elektronike dhe e njëjta mirëmbahet nga Drejtoria e Administratës.

### Neni 3

Ky plotësim-ndryshim i Rregullores Nr.02/2017 për Pagat dhe Kompensimet tjera në KMDK SH.A, hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të KMDK SH.A.

Prishtinë, 29.09.2023

  
Izja Mjeku

Kryesues i BPD në KMDK SH.A

